

trat përreth. Të nesërmen, më **23.09.1998**, forcat serbe që nga mëngjesi e bombardonin pyllin në të cilin ishin grumbulluar refugjatët [bjeska e *Çiçavicës/Čičavica*]. Një predhë ka rënë në afërsi të traktorit ku ishin Hasimja me fëmijët. Ajo u plagos në gjoks. Ka ndërruar jetë në mëngjesin tjetër. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Hasimen në varrezat e fshatit Baks.

**Burimet:** deklarata N.S, FDH-18747; ICTY, IT-05-87 (S. Milošević), Ex.P.01434, FDH-33273; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

### Mahmut (Beqe) Xhemajlaj

(27.04.1927, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glogocit/Glogovac, pensionist, tre fëmijë)

Mahmuti punonte para lufte si shef i hotelit *Drenica*. Ai me familje e braktisën fshatin [Obria e Epërme/Gornje Obrinje] nga mesi i muajit shtator të vitit 1998. U strehuan te farefisi në **Kozhicë/Kožica**. Për shkak të sulmit të forcave serbe mbi Kozhicën/Kožica [22.09.1998], Mahmuti me familjarët kaluan në bjeshkën e *Çiçavicës/Čičavica*. Gjendeshin në mes të shtënave dhe krismave tërë ditën. Bombardimi vazhdoi edhe ditën e nesërme [23.09.1998]. Rreth orës 15:00, u plagosën dy mbesa të Mahmutit. Ai vrapoi që tu ndihmonte dhe në atë çast në afërsi të tij ka eksploduar një granatë, duke e lënë të vdekur në vend. Dy ditë më vonë, familjarët e kanë varrosur Mahmutin në varrezat e Kozhicës/Kožica. Pas lufte, në përvjetorin e rënies së Mahmutit, familjarët i kanë riarrosur mbetjet e tij mortore në varrezat e Obrisë së Epërme/Donje Obrinje.

**Burimet:** deklarata F.X, FDH-16540; KMDLNI, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 114, FDH-23857; ICTY, IT-05-87 (S. Milošević), Ex.P.01434, FDH-33273; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

### Shiqeri (Islam) Islami

(1941, shqiptar nga Dasheci/Doševac, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë)

Shiqeriu me bashkëshorten Fatimen, nipin Arjanitin, bashkëshorten e të vëllait dhe vajzat e veta e braktisën fshatin [Das-

hec/Doševac] më 23.09.1998, pasi që forcat serbe kanë hyrë në fshat. Shiqeriu me gratë dhe fëmijët, si dhe farefisi i gjerë dhe banorë të tjerë, u strehuan në pyllin e fshatit fqinj të **Kozhicës/Kožica** [bjeska e *Çiçavicës/Čičavica*]. Atje u takuan me anëtarë të tjerë të familjes. Shiqeriu ka pësuar nga eksplodimi i granatës rreth orës 11:00, më **23.09.1998**. Trupi i tij ka mbetur në vendin e vrasjes në dy ditë e ardhshme, ndërkaq, pas tërheqjes së forcave serbe, i biri Bedriu me kushërinj e kanë varrosur Shiqeriu në varrezat e fshatit Dashec/Doševac.

**Burimet:** deklarata F.I, FDH-36669; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256; *Serb Offensive in Drenica Steps Up, Many Albanians Killed and Slain*, pasqyra e lajmeve, KIC, 26.09.1998, FDH-33990.

### Sadri (Hashim) Veliqi

(1950, shqiptar nga Polaci/Poljance, komuna e Skënderajt/Srbica, shofer, gjashtë fëmijë, civil)

Shumica e banorëve të Polacit/Poljance e kanë braktisur fshatin në fillim të muajit shtator të vitit 1998. Sadriu me disa kushërinj kanë mbetur në fshat. Në datën 22.09.1998, ata u strehuan në pyll të afërt për shkak të bombardimeve të fuqishme. U kthyen në fshat në mbrëmje. Bombardimet vazhduan edhe përgjatë tërë natës dhe Sadriu me farefisn kaluan ditën tjetër [23.09.1998] në bjeshkën e *Çiçavicës/Čičavica*, në pyll përmbi fshatin **Kozhicë/Kožica**. Forcat serbe vazhduan me bombardimin e pyllit edhe atë ditë. Sadriu me tre kushërinjtë e tij shkuan deri te maja e bjeshkës, ku u takuan me një grup të burrave të zhvendosur. Nga ora 13:30, grupi i burrave, në mesin e tyre edhe Sadriu, u rret-hua nga katër ushtarët serb. Burrat shqiptar tentuan që të iknin me vrap. Atëherë, ushtarët hapën zjarr ndaj tyre. Kushërinjtë e Sadriut vërejtën se ai nuk ia doli që të largohej nga vendi i ngjarjes. I afërmi i tij, Haliti, u kthye atje pas një ore. E ka gjetur trupin e pajetë të Sadriut. Pranë tij gjendej edhe një trup tjetër i një burri të panjohur, të cilin Haliti nuk mundte ta identifikonte. Sadriu e kanë varrosur po atë ditë në varrezat e fshatit Polac/Poljance.